Albanisch

MiMi Gewaltprävention
Mit Migranten
für Migranten

Mbrojtja nga dhuna në Gjermani

Udhëzues për burra refugjatë dhe të sapoardhur

Mbështetur nga:

Die Beauftragte der Bundesregierung
für Migration, Flüchtlinge und
Integration

Ethno-
Medizinisches
Zentrum e.V.

Impressum

Gewaltschutz in Deutschland – Ratgeber für geflüchtete und neuzugewanderte Männer

Herausgeber:
Ethno-Medizinisches Zentrum e. V.
Königstraße 6, 30175 Hannover

Konzeption, Inhalt, Erstellung:
Duale Hochschule Baden-Württemberg Villingen-Schwenningen (DHBW)
– Institut für Transkulturelle Gesundheitsforschung
Ethno-Medizinisches Zentrum e. V. (EMZ e. V.)
– MiMi Integrationslabor Berlin (MiMi Lab)

Förderung: Beauftragte der Bundesregierung für Migration, Flüchtlinge und Integration

Projektleitung: Ramazan Salman (EMZ e. V.), Prof. Dr. Dr. Jan Ilhan Kizilhan (DHBW)

Redaktion: Prof. Dr. Dr. Jan Ilhan Kizilhan, Claudia Klett, Ahmet Kimil, Laura Przybyla, Anne Rosenberg, Ramazan Salman, Andreas Sauter, Silvio Schelle

Layout und Satz: eindruck.net

Übersetzung: Dolmetscherdienst – Ethno-Medizinisches Zentrum e. V.

Bildquellen: Umschlagbild iStock.com/BijoyVerghese
Seite 2: iStock.com/IG_Royal · Seite 8: iStock.com/KatarzynaBialasiewicz
Seite 15: iStock.com/lathuric · Seite 18: iStock.com/tomozina
Seite 27: iStock.com/nanmulti · Seite 30: iStock.com/BrianAJackson

Alle Rechte vorbehalten. Das Werk ist urheberrechtlich geschützt. Jede Verwendung in anderen als den gesetzlich zugelassenen Fällen bedarf deshalb der vorherigen schriftlichen Genehmigung durch den Herausgeber.

Diese Publikation können Sie jederzeit über die Webseiten „www.mimi-gegen-gewalt.de“ oder „www.mimi-bestellportal.de“ in folgenden Sprachen anfordern: Deutsch, Albanisch, Arabisch, Bulgarisch, Dari, Englisch, Farsi, Französisch, Kurdisch (Kurmanci), Paschto, Russisch, Serbisch/Kroatisch/Bosnisch, Türkisch

1. Auflage · Stand: November 2018

Fjalë përshëndetjeje

Të dashur lexuese dhe lexues,

çdo njeri ka të drejtë të jetojë sipas vendimeve të veta dhe pa ankth dhe dhunë. Projekti i mbarë Gjermanisë "MiMi-parandalimi i dhunës me migrantë për migrantë", që boton këtë revistë këshilluese, angazhohet me punën e vet për këtë synim.

Inkurajon dhe shkollon burra me prejardhje migracioni, me qëllim që si ndërmjetësues të informojnë rreth ligjeve dhe rregullave tona të bashkëjetesës dhe me anë të kësaj të kontribuojnë edhe në mënyrë aktive për parandalimin e dhunës. Puna e ndërmjetësuesve është e rëndësishme, sepse kush ka ardhur në Gjermani si refugjat ose imigrant, gjen vetën para disa sfidave: Nuk është e lehtë, të orientohesh në një vend të ri dhe të kuptosh rregullat dhe zakonet e vendit pranues. Në vështrim të parë, shumë gjëra duken të pazakontë, disa të pakuptueshme. Këtu e nisin ndërmjetësuesit, shpjegojnë të drejta dhe prezantojnë oferta përkrahëse dhe ndihmëse. Ndërmjetësuesit e dinë nga përvoja e vet, sa sfiduese mund të jetë mbërritja në një mjedis të ri dhe në rrethana të panjohura. Sidomos, kur ekzistojnë edhe përvoja traume. Me punën e tyre japin një kontribut të pazëvendësueshëm për një mbërritje dhe një jetë të mirë në Gjermani.

Kjo revistë këshilluese merret me pyetje të rëndësishme për mënjanimin e dhunës. Në faqet vijuese prezantohen bazat juridike dhe ligjet për mbrojtjen nga dhuna dhe tregohen rrugëdaljet nga dhuna. Revista këshilluese u drejtohet burrave refugjatë dhe të sapoardhur si imigrantë si dhe të gjithëve, që bashkëveprojnë për parandalimin e dhunës dhe që angazhohen për një bashkëjetesë pa dhunë dhe paqësore në vendin tonë.

Me përshëndetje të përzemërta

Annette Widmann-Mauz
Ministre Shteti pranë Kancelares Federale dhe Personi Përgjegjës i Qeverisë Federale për Migracionin, Refugjatët dhe Integrimin

Përmbajtje

Hyrje 4

1. Çfarë është dhuna? 6

Çfarë formash të dhunës midis njerëzve ekzistojnë? | Ku ushtrohet dhunë midis njerëzve? | Çfarë pasojash ka dhuna për të cenuarit? | Pasojat për fëmijë

2. Kur vlerësohet diçka si dhunë? 14

Vlera dhe normativa si justifikim dhune | Ndryshim në qëndrimin ndaj dhunës | Çfarë rëndësie kanë vlerat dhe traditat në emigrim? | Baza ligjore dhe ligje në Gjermani | Monopoli i shtetit për ushtrimin e dhunës në Gjermani

3. Pse ekziston dhuna? 24

Rrethana shoqërore – dhunë dhe pushtet | Çfarë konceptesh e justifikojnë dhunën? | Dhuna kulturore dhe fetare | Kultura e dhunës | Shkaqe psikologjike për sjellje të dhunshme | Pasojat për autorin – a sëmuren njerëzit, që ushtrojnë dhunë?

4. Rrugëdaljet nga dhuna 32

Çfarë mund të bëj kundër dhunës? | Ku mund të gjej ndihmë? | Mundësi këshillimi | Psikoterapi | Kurse për një edukim pa dhunë

Fjalor 36

Adresa të zgjedhura kontakti 40

Hyrje

Kujt i drejtohet ky udhëzues?

Dhuna ekziston në të gjitha vendet e botës, megjithatë në forma dhe situata të ndryshme si dhe në masa të ndryshme. Edhe mundësitë dhe procedurat për mbrojtjen nga dhuna ndryshojnë nga vendi në vend. Ky udhëzues synon të ndihmojë për të lehtësuar orientimin në Gjermani në pyetje rreth temës së dhunës. Synon të informojë për mundësitë e mbrojtjes dhe mbështetjes, si dhe rreth mundësive se si ta njohësh dhe ta ulësh sjelljen e dhunshme tek vetvetja ose te të tjerët. U drejtohet të gjithë të interesuarve për temën, që njohin persona të cenuar nga dhuna, si viktimë ose si autor, ose që duan të angazhohen për një sjellje plot respekt me njëri-tjetrin. Një temë e posaçme është sjellja plot respekt me partneren/partnerin dhe brenda familjes.

Me këtë synim, ky udhëzues u drejtohet në veçanti burrave refugjatë dhe të sapoardhur.

Burra dhe gra janë cenuar në forma dhe masa të ndryshme nga dhuna, dhe gjithashtu e ushtrojnë dhunën në mënyra të ndryshme. Edhe marrja me përjetimet e dhunshme dhe pasojat dallohen, prandaj ka rëndësi, që të ekzistojnë informacione për burra dhe gra veç e veç. Për gra refugjate dhe të sapoardhura ekziston një udhëzues i veçantë.

Në këtë udhëzues gjithashtu merret parasysh situata e veçantë e refugjatëve dhe e të sapoardhurve, të cilët u rritën në vende dhe shoqëri, në të cilat format dhe masa e dhunës, por gjithashtu qëndrimi ndaj dhunës kundrejt partneres/partnerit dhe në familje dhe marrja me këtë dallohen shumë nga rrethanat në Gjermani.

Çfarë përmban ky udhëzues?

Para se të flasim për mbrojtjen nga dhuna, ka rëndësi të sqarojmë, çfarë saktësisht është kuptimi i fjalës dhunë. Kjo është përmbajtja e kapitullit 1. Dhuna mund të ketë forma dha masa krejtësisht të ndryshme. Një sistemim mund të ndihmojë për të kuptuar, se çfarë lloji gjërash bëjnë pjesë tek dhuna. Përkatësisht, dhuna sjell gjithashtu pasoja të ndryshme për të cenuarit. Për mbrojtjen nga dhuna dhe për ndihmën në përjetime të dhunës është e dobishme të njohësh pasojat e mundshme. Disa herë nuk kujtohet farë lidhja e shqetësimeve shëndetësore pas dhunës me po atë dhunë. Veç kësaj pasojat tregojnë qartazi, përse ka kaq shumë rëndësi të parandalohet dhuna.

Në kapitullin 2 bëhet fjalë për sqarimin, kur ushtrimi i dhunës mund të jetë i justifikueshëm, për shembull nëse nëpërmjet kësaj mbrohen njerëz. Në ç'raste dhuna vlerësohet si e ligjshme dhe në ç'raste e padrejtë, kjo dallohet nga vendi në vend. Kjo gjë varet nga vlerat e shoqërisë përkatëse, por edhe nga forma dhe nga ligjet e një shoqërie.

Edhe nga personi në person mund të ketë dallime, se çfarë perceptohet si dhunë dhe çfarë pranohet si një sjellje normale. Për mbrojtjen nga dhuna ka rëndësi që gjithsecili të njohë konceptet e veta për këtë, por të njohë gjithashtu konceptet e shoqërisë, në të cilën jeton. Këtu përfshihen edhe të drejtat dhe ligjet përkatëse.

Për të kuptuar, përse ekziston dhuna midis njerëzve, ka rëndësi të vështrojmë kornizën shoqërore dhe shpërndarjen e pushtetit në një shoqëri. Kjo është tema e kapitullit 3. Kur vështrojmë njerëzit veç e veç, gjithashtu ngarkesa psikike dhe sëmundje psikike mund të jenë arsye për veprime të dhunshme. Në varësi të arsyes dhe të rrethanave nevojiten pikënisje të ndryshme për ta ulur dhunën.

Në kapitullin 4 përshkruhet, kujt mund t'i drejtohen të cenuarit, nëse janë viktima dhune. Emërtohen gjithashtu zyra kontaktuese për personat, që ushtrojnë dhunë dhe duan t'i japin fund kësaj.

1. Çfarë është dhuna?

Dhuna është një rrezik për shëndetin dhe nganjëherë edhe për jetën e njerëzve. Prandaj Organizata Botërore e Shëndetësisë (WHO) merret me këtë. Në raportin e saj, që është "Raporti botëror i dhunës dhe i shëndetit" i vitit 2003, ajo e përshkruan dhunën kështu:

"Përdorimi i qëllimshëm i detyrimit *fizik të kanosur ose të realizuar ose i pushtetit fizik ndaj vetes së vet ose ndaj një personi tjetër, ndaj një grupi ose bashkësie, i cili ose konkretisht ose me gjasa të mëdha rezulton në plagosje, vdekje, dëmtime psikike, zhvillime anormale ose në *deprivim*."**

Pra, dhuna përfshin

- mënyrat e dëmshme të sjelljes, që ushtrohen nga një person kundër vetvetes (për shembull plagosja e vetvetes ose vetëvrasja)
- dhunën, që ushtrohet nga një person ose disa persona të tjerë (për shembull keqtrajtim në familje, sulmime nga persona të panjohur ose sulmime në shkollë ose në vendin e punës)
- ushtrimin e dhunës nga ana e grupeve më të mëdha si shtete, *milicë* ose organizata terroriste me synimin të realizojnë interesa politikë, ekonomikë ose shoqërorë (për shembull grindje të armatosura, gjenocid, mosrespektim i të drejtave të njeriut ose terrorizëm)

Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë, veprime të dhunshme nuk përfshijnë vetëm plagosje, por edhe kërcënime gojore dhe kanosje. Pika e përbashkët e të gjitha veprimeve të dhunshme është, që pasojat janë ose mund të jenë të dëmshme për shëndetin fizik ose psikik të një personi ose të disa personave, dhe që këto pasoja mund të rezultojnë deri në vdekje.

Sot njëkohësisht me fjalën dhunë kuptohet gjithashtu "cenimi i realizimit të vetvetes" i një personi. Kjo do të thotë, që një person është i kufizuar në vendimet, se si ai ka dëshirë të formojë jetën e vet. Kjo mund të bëhet nga individët, por gjithashtu nga rregullat e caktuara në ente ose institucione ose nëpërmjet shpërndarjes së pabarabartë të pushtetit në shoqëri. Pra, për një mbrojtje afatgjatë nga dhuna, edhe rrethanat shoqërore duhen marrë parasysh.

Ky udhëzues merret në vijim njëherë me dhunën midis njerëzve, pra, nëse dhuna ushtrohet nga një ose disa persona.

** Termat e fjalorit në tekst janë theksuar me shkrim kursiv*

ÇFARË FORMASH TË DHUNËS MIDIS NJERËZVE EKZISTOJNË?

Dhuna midis njerëzve mund të ketë forma më të ndryshme:

- **dhuna fizike (ndaj trupit)**
  për shembull: rrahje, goditje me shqelma, sulmime me sende të të gjitha llojeve, kapje për flokë, shuplaka, shtyrje, kapje për fyt, tundje, djegje dhe sulmime me acid
- **dhuna psikike (ndaj shpirtit)**
  për shembull: ofendime, korrigjime të pandërprera, fyerje, poshtërime, qesëndisje (edhe në publik), shantazhe, kërcënime (për shembull t'u bësh gjë atij personi vetë ose fëmijëve ose t'ia heqësh fëmijët)
- **dhuna seksuale**
  për shembull: detyrim kundër vullnetit të vet për të kryer veprime seksuale, përdhunim, detyrim për prostitucion ose shtrëngim për incizim të pikturave/filmave gjatë veprimeve seksuale

Veçanërisht në fushën private ekzistojnë gjithashtu këto forma dhune:

- **dhuna *sociale***
  për shembull: kontrollime të pandërprera, urdhërim që tjetri të mos mbajë kontakte, të mos marrë pjesë në një kurs gjuhe, të mos dalë nga shtëpia, detyrim për *normativa* dhe vlera kundër vullnetit të tjetrit
- **dhuna financiare**
  për shembull: krijimi i një varësie financiare, urdhërim që tjetri të mos dalë në punë ose të bëjë një formim profesional, kontrollimi i vetëm i të gjitha parave të disponueshme

KU USHTROHET DHUNA MIDIS NJERËZVE?

Dhuna midis njerëzve mund të ushtrohet në vende të ndryshme dhe në rrethana të ndryshme:

- **në publik**
  për shembull në autobus ose në tram, në disko
- **në institucione**
  për shembull në strehimoren e përbashkët, nëpër shoqata, në vendin e punës ose në shkollë
- **në fushën private**
  për shembull nga ana e anëtarëve të familjes, të afërmve ose miqve
- nëse ushtrohet dhunë midis partnerëve të rritur të një marrëdhënieje ose midis ish-partnerëve të një marrëdhënieje, atëherë flitet edhe për **"dhunë në familje"** gesprochen. Nga kjo cenohen më shumë gratë.

Në Gjermani, afërsisht një në katër gra njëherë në jetën e saj bëhet viktimë dhune, që ushtrohet nga partneri ose ish-partneri i saj.

Mundësitë për të mbrojtur veten janë ndryshe nga vendi në vend. Nëse ekziston një marrëdhënie ose varësi ndaj personit, që ushtron dhunë, për shembull ndaj mësuesit, eprorit ose brenda familjes, atëherë është më e vështirë, të mbrosh veten nga dhuna, sesa kundrejt një personi të panjohur.

Veç kësaj, pasojat e dhunës janë më të rënda për personin e cenuar. Posaçërisht të rënda janë pasojat e dhunës brenda familjes, nga që kjo ndodh në ambientet private, të cilat normalisht duhet të ofronin mbrojtje. Këtu dhuna ushtrohet nga njerëzit më të afërt, që normalisht duhet të jepnin mbështetje dhe mbrojtje.

Në shumicën e rasteve të dhunës në familje, autorët janë burra dhe viktimat janë gra. Gjithmonë të bashkë-cenuar janë fëmijët.

ÇFARË PASOJASH KA DHUNA PËR TË CENUARIT?

Ka pasoja më të ndryshme të dhunës për të cenuarit. Nga njëra anë, ka ndryshime të mëdha tek dhuna e pësuar. Nga ana tjetër, çdo person reagon ndryshe. Ka gjithashtu rëndësi, sa mbështetje merr një person i cenuar nga familja e vet, nga miqtë ose nga personat e tjerë.

Nëse një person mund të flasë me dikë për dhunën e pësuar dhe nëse gjen ndjeshmëri për këtë, për shembull me partnerin ose me partneren ose me një shoqe ose një shok, atëherë kjo shpesh mbështet shërimin.

Dhuna në familje nuk është çështje private, por një vepër penale

Dhuna për të cenuarit shpesh ka pasoja në fusha më të ndryshme të jetës. Disa nga pasojat janë të dukshme, të tjera ngelen të padukshme. Disa pasoja shfaqen direkt pas ngjarjes së dhunës, disa shfaqen vetëm muaj ose madje edhe vite më vonë. Prandaj nganjëherë mund të jetë e vështirë të zbulohet përjetimi i dhunës si shkaku i pasojave.

Pasojat për shëndetin

Dëmtime të shpeshta të trupit janë:

- thyerje kockash, dëmtime të organeve të brendshme, hemorragji të brendshme, dëmtime truri (si pasojë të goditjeve në kokë ose të rrëzimeve si pasojë shtyrjesh), plaga me shërim të vonuar dhe vurrata (për shembull si pasojë të prerjeve, djegieve me lëndë të nxehtë ose kimike), pezmatime, ulje të aftësisë së shikimit dhe të dëgjimit
- Në përdhunime, pra në akte seksuale të detyruara, veç kësaj: plagosje dhe hemorragji anale, dhimbje të vazhdueshme gjatë aktit seksual, pezmatime të fshikëzës së urinës dhe të veshkave, sëmundje seksuale dhe infektime, shterpësi, çrregullime funksionale seksuale (tek vajzat dhe gratë ka edhe dështime, shtatzëni të padëshiruara si dhe plagosje dhe hemorragji vagjinale)

Disa prej këtyre lëndimeve dhe sëmundjeve fizike mund të shërohen. Për këtë, një kujdesje mjekësore ka shumë rëndësi.

Dëmtimet shëndetësore nga dhuna nuk cenojnë vetëm trupin, por gjithashtu shpirtin ose *"psikikën"*.

Pasoja të shpeshta për shëndetin psikik (të shpirtit) janë:

- çrregullime gjumi, gjendje ankthi (panik ose frikë nga vdekja në situata të parrezikshme, frikë për të dalë nga banesa ose dhoma), dhimbje koke, përzierje, mosbesim i madh ndaj personave të huaj, *depresione,* trishtim dhe dëshpërim i madh, ndjenje turpi ose faji, flashback (të përjetohet sërish përvoja e dhunës në mendime), agresion dhe inat, varësi nga drogat ose ilaçet (për shembull ilaçe kundër dhimbjes), mendime vetëvrasjeje ose përpjekje vetëvrasjeje

Veçanërisht në rastin e dhunës seksuale shpesh ka edhe:

- neveri për trupin e vet, neveri për seksualitetin, sjellje seksualisht e ekzagjeruar, humbje e ndjenjës së kënaqësisë seksuale deri në *disfunksionim* të seksualitetit

Veçanërisht pasojat psikike jo gjithmonë shihen në lidhje me përjetimin e dhunës, por vlerësohen si "paaftësi" ose "dobësi" e vetvetes. Kjo mund të forcojë ndjenjën e të qenit vetë pa vlerë dhe mund të vështirësojë një shërim. Mund të ndodhë gjithashtu, që familja ose miqtë të mos e kuptojnë këtë lidhje dhe të kritikojnë sjelljen ose të ushtrojnë presion. Kjo gjithashtu mund të vështirësojë një shërim.

Kështu si shumë plagosje kanë nevojë për trajtim mjekësor dhe kujdesje për të shëruar mirë, ashtu edhe shumë lëndime psikike kanë nevojë për trajtim dhe kujdesje. Për trajtimin profesional të lëndimeve psikike, *psikoterapistë* dhe *psikoterapiste* si gjithashtu dhe *psikiatër* dhe *psikiatre* janë të arsimuar. Ata i nënshtrohen *detyrimit të ruajtjes së sekretit*. Ata nuk kanë leje të flasin me askënd për atë, çfarë bisedohet me ta (shihni kapitullin 4 Rrugëdaljet nga dhuna).

Pasojat familjare dhe sociale

Njerëzit si qenie sociale kanë nevojë për kontakte sociale. Këto për shembull janë familja, miqtë dhe të afërmit e tyre ose kolegët e tyre të punës. Megjithatë, dhuna midis njerëzve shpesh ushtrohet nga pikërisht këta njerëz të këtij mjedisi social. Rrallë autorët janë persona plotësisht të huaj. Veçanërisht atëherë dhuna për të cenuarit ka gjithashtu pasoja të mëdha sociale.

Izolim nga familja ose nga mjedisi social
Për shembull, nëse dhuna nga ana e partnerit përfundohet me ndarje ose shkurorëzim, ekziston mundësia, që si shtesë përjetohet edhe refuzimi nga ana e familjes. Jo gjithmonë të afërmit i përkrahin viktimat e dhunës, posaçërisht nëse këto janë gra. Në disa raste mbrohen autorët, posaçërisht kjo ndodh shpesh, nëse këta janë burra.

Shkaku për këtë janë konceptet rreth kësaj, se kush posedon cilat të drejta në një marrëdhënie. Kështu, viktimat e dhunës si shtesë përjetojnë vetmi, ndjenja të të qenit fajtor dhe ngushticë financiare. Nëse njëri prind refuzohet nga prindi tjetër ose nga familja, atëherë gjithmonë edhe fëmijët vuajnë nga kjo gjë. Me anë të kësaj refuzohet një pjesë të identitetit të tyre.

Kështu ju mund të ndihmoni

Ndoshta njihni njerëz në familje ose në *shoqërinë* tuaj, të cilët kanë një sjellje të çuditshme ose sjellja e të cilëve u ndryshua. Ndoshta njihni njerëz, që janë agresiv ose inatosen shpejt, ose që papritur i shmangen kontaktit dhe tërhiqen. Është e mundur, që shkaku i kësaj është një përjetim dhune. Këtu mund të jetë një ndihmë, që sjellja të mos shikohet si e gjë qëllimshme, por si shprehje e një lëndimi psikik. Mund të jetë një ndihmë, që ta mbani ose kërkoni kontaktin me këta njerëz në mënyrë të butë, por pa i shtyrë ata.

Influenca e familjes

Presioni social lind nga pritjet, të cilat familja ose mjedisi social i shpreh për sjelljen e një personi. Këto pritje ndër të tjera varen nga gjinia. Kështu shpesh ekzistojnë koncepte të caktuara, se si një burrë dhe si një grua (njëkohësisht gjithashtu si një djalë dhe një vajzë) duhet të sillet, çfarë vlerësohet si e duhur dhe si e gabuar. Konceptet, se si burrat duhet të sillen, shpesh janë lidhur me idetë e "forcës", "mbrojtësit" ose "kryefamiljarit"

Në disa raste kjo çon deri në këtë, që djemtë ose burrat detyrohen nga ana e familjes të ushtrojnë dhunë, për shembull te konceptet për mbrojtjen e "nderit" të një familjeje.

Nëse burrat bëhen viktima dhune, atëherë mund të ndodhë, që ata nuk mund të plotësojnë më këto pritje, sepse vetë kanë nevojë për ndihmë dhe përkrahje. Kjo mund të rezultojë në konflikte ose në refuzim nga familja ose nga mjedisi social, por gjithashtu në këtë, që të cenuarit e refuzojnë vetveten. Njëkohësisht edhe dhuna e pësuar i kundërvihet konceptit të një "burri të fortë". Veçanërisht në dhunë seksuale, viktimat shpesh ndjejnë një turp ose faj të madh dhe për këtë arsye nuk mund të bisedojnë me njerëz të afërt rreth përjetimit.

Viktimat e dhunës, pavarësisht a janë burra a gra, asnjëherë nuk janë përgjegjës për dhunën, që u ushtrua ndaj tyre.

Nëse dhuna pësohet për një kohë më të gjatë, kjo mund të rezultojë në një tërheqje më të fortë nga mjedisi social. Besimi në sigurinë e vetvetes humbet. Konceptet e veta të vlerave ndryshojnë. Bota përjetohet si kërcënuese. Vajtja në punë bëhet e vështirë.

Pasojat e rënda familjare dhe sociale mund të rezultojnë në këtë, që një person i cenuar më mirë i pranon pasojat e forta shëndetësore dhe i lë përjetimet e pësuara të dhunës në heshtje ose madje i duron ato më tej.

Ndihmë nga zyrat e këshillimit

Zyrat e këshillimit për viktima dhune ofrojnë ndihmë profesionale edhe në këto raste. Atje mund të bisedohet për pasojat dhe ato mund të peshohen, si dhe mundësi mbështetjeje mund të gjendën. Personi i cenuar gjithmonë vendos vetë, se çfarë ofertash ndihme dëshiron të pranojë dhe nëse dëshiron të parashtrojë një *kallëzim* tek policia. Në këshillim asnjëri nuk refuzohet për përvojat ose vendimet e tij, por të cenuarit trajtohen gjithmonë me respekt dhe ndjeshmëri. Edhe këtu vlen detyrimi i ruajtjes së sekretit, këshilluesit ose këshillueses nuk li lejohet, t'i transmetojë askujt përmbajtjen e bisedave.

Veçanërisht për dhunën në familje ose dhunën seksuale ekzistojnë shumë oferta ndihme, që u drejtohen posaçërisht grave të cenuara, nga që në shumicën e rasteve të dhunës në familje dhe të dhunës seksuale gratë janë personat e cenuar. Gjithashtu për burrat e cenuar ekzistojnë oferta ndihme të specializuara në varësi të rajonit.

Oferta mbështetjeje ekzistojnë gjithashtu për burrat, që ushtrojnë dhunë dhe duan të mësojnë t'i trajtojnë njerëzit e tjerë me respekt ose të merren me konflikte pa ushtruar dhunë (shihni kapitullin 4 Rrugëdaljet nga dhuna).

PASOJA PËR FËMIJË

Nëse fëmijë bëhen viktima dhune, pasojat në shumë fusha janë të ngjashme me ato të të rriturve. Edhe fëmijë marrin lëndime fizike dhe psikike. Megjithatë, ka mënyra të ndryshme se si ata merren me ato. Kështu, disa fëmijë bëhen shumë të qetë dhe tërhiqen, të tjerë reagojnë shpejt agresiv dhe inatosen kollaj. Gjithashtu mund të ndodhë, që fëmijët përpiqen të mos duket asgjë për t'i mos ngarkuar prindërit.

Çfarë i ndihmon fëmijët të flasin në përgjithësi për përjetimin e dhunës, është një marrëdhënie plot dashuri dhe mbështetje me prindërit.

Edhe dhuna midis prindërve ("dhunë në familje") ka pasoja të rënda për fëmijët. Gjithashtu nëse fëmijët nuk rrihen, fyen ose përdhunohen vetë, por vetëm e shikojnë ose dëgjojnë grindjen midis prindërve ose nëse e vënë re atë në mënyrë indirekte. Pasojat psikike janë po aq të rënda, sikur fëmija vetë të ishte viktima e drejtpërdrejtë:

- ndjenja e të qenit vetë pa vlerë
- zhgënjimi për dobësinë e njërit prindi, rritja e paaftësisë për të ndihmuar vetveten edhe në situata të tjera të jetës
- përkeqësime në arritjet shkollore
- miratimi i autorit, sepse fuqia e tij gabimisht perceptohet si siguri

- adaptimi i roleve për burra dhe gra si shembull: fëmijët, që kanë përjetuar dhunë në familje, jo rrallë bëhen vetë autorë ose viktima në marrëdhënien e mëvonshme
- ngarkesa e mbajtësit të sekretit: prindërit shpesh ua ndalojnë fëmijëve të flasin me persona jashtë familjes për dhunën midis prindërve, nga që autori përndryshe mund të dënohej nga gjykata. Shpesh kjo gjë është një presion i madh për fëmijët, ata ndihen fajtorë dhe nuk arrijnë të pranojnë ndihmë
- *traumat* e rënda: shuarja totale dhe mënjanimi total i përjetimeve mund të rezultojnë në tërheqje sociale, në rastin me të keq në vetëvrasje

Fëmijët si viktima të dhunës nga ana e prindërve

Për fëmijët pasojat janë më dramatike, nëse ndaj tyre ushtrohet dhuna e drejtpërdrejtë nga ana e prindërve ose nga ana e familjarëve të afërm. Për fëmijët, besimi ndaj njerëzve të tjerë shpesh dëmtohet fortë, sepse pikërisht këta njerëz, që duhet të kujdeseshin për ta dhe duhet t'i mbronin ata, ushtrojnë dhunë ndaj tyre. Shtëpia e vet pastaj nuk u ofron më mbrojtje, por bëhet një vend vuajtjesh, prej të cilit fëmijët shumë vështirë që mund të arratisen.

Gjithashtu fëmijët futen nëpërmjet kësaj edhe në një siklet të madh psikik. Shumë nuk i lejojnë vetes të refuzojnë prindin e dhunshëm për dhunën e ushtruar ndaj tyre, por përpiqen të gjejnë fajin tek vetja ose fillojnë ta urrejnë vetveten. Gjithashtu shumë fëmijë e durojnë dhunën në heshtje, sepse nuk duan, që eventualisht familja të prishet. Ose ata vihen në presion nga prindi t'u mos thonë gjë të tjerëve.

Nëse fëmijët pësojnë dhunë për një kohë të gjatë, atëherë kjo mund të rezultojë në një çrregullim të qëndrueshëm të zhvillimit të personalitetit të tyre. Kjo do të thotë, që personaliteti i tyre është i lënduar gjithashtu në moshë madhore, edhe nëse tashme ka kohë që dhuna mbaroi. Sëmundje psikike si *„borderline"* ose një *„çrregullim personaliteti me ankth dhe reagime shmangieje"* janë pasoja të mundshme.

Nëse ekziston dyshimi, që një fëmijë përjeton dhunë nga prindërit e vet, atëherë duhen bërë hapa të kujdesshëm për të mos forcuar presionin ose dhunën nga ana e prindërve. Një bisedë këshillimi pranë një zyre këshillimi ose në telefonin e ndihmës kundër dhunës (shihni kapitullin 4 Rrugëdaljet nga dhuna) mund të ndihmojë për të folur rreth mundësive të ndihmës, që e mbrojnë fëmijën më mirë.

2. Kur vlerësohet diçka si dhunë?

Nganjëherë sjelljet e dhunshme tolerohen nga familja ose shoqëria pavarësisht nga pasojat e rënda, pra ato nuk dënohen ose kuptohen si "diçka normale". Nganjëherë këto madje kërkohen ose shikohen si të drejta për shkak të traditave ose ligjeve shtetërore. Kur dhuna vlerësohet si e justifikuar ose e nevojshme, kjo dallohet nga vendi në vend respektivisht nga shoqëria në shoqëri në varësi të vlerave dhe normativave përkatëse.

Veç kësaj, pranimi i përgjithshëm i dhunës në një shoqëri dallohet nga tipi i shoqërisë. Në Gjermani si "tip modern i shoqërisë", dhuna lejohet vetëm të ushtrohet me urdhër shtetëror dhe vetëm atëherë, nëse nuk ekziston asnjë mundësi tjetër për ta parandaluar dhunën (shihni kapitullin poshtë "Monopoli i shtetit për ushtrimin e dhunës në Gjermani"). Në këtë rast nuk flitet për dhunë, por për kompetenca të forcës ekzekutive ose për masa policore. Synimi i tyre është të mbrojnë nga rreziqet dhe të parandalojnë vepra penale. Policia në Gjermani duhet të zbatojë ligjet e caktuara në ushtrimin e masave (Ligji Policor).

Në të gjitha rastet e tjera, dhuna është e dënueshme me ligj. Synimi është, që në mënyrë afatgjatë me anë të kësaj të ulet dhuna më shumë e më shumë.

VLERA DHE NORMATIVA SI JUSTIFIKIMI DHUNE

Në disa rajone ose vende, sjellje të dhunshme tolerohen nga familja ose shoqëria pavarësisht nga pasojat e rënda për viktimat. Në këtë perceptim, ato vlerësohen si "normale" dhe nuk dënohen. Nganjëherë këto madje kërkohen ose vlerësohen si të drejta për shkak të zakoneve tradicionale ose ligjeve shtetërore.

Shembuj:

- Në disa vende, burrat kanë të drejtën ligjore të kontrollojnë vendimet ekonomike të grave të tyre. Grave u lejohet vetëm në kushte të paracaktuara saktësisht të fillojnë një punë dhe kështu të fitojnë vetë para (> dhuna financiare).
- Zakone tradicionale në disa rajone kërkojnë, që vajzave t'u hiqen pjesë të tëra të trupit, domethënë *klitori* dhe buzët e vagjinës. Rrethprerja e organeve gjinore femërore është dhunë (> dhuna fizike).
- Në disa vende ekzistojnë arrestime arbitrare, të arrestuarit pjesërisht poshtërohen, torturohen ose përdhunohen nga ana e anëtarëve të policisë ose të shërbimit sekret dhe nuk kanë asnjë mundësi të çojnë atë si padrejtësi përpara gjykatës (> dhuna psikike, fizike dhe seksuale).

- Në disa vende, burri nëpërmjet martesës ka të drejtë ta kryejë aktin seksual me gruan e tij, kurdo që të dojë ai. Gruaja nuk ka asnjë mundësi të vendosë bashkë me të, nëse ajo në këtë moment ka dëshirë për të kryer aktin seksual apo jo. Nëse akti seksual kryhet kundër vullnetit të gruas, atëherë ky është një përdhunim, që në Gjermani dënohet me ligj. (> dhuna seksuale). Natyrisht, kjo edhe vlen, nëse të dy nuk janë të martuar.

Pra, nga shoqëria në shoqëri, nganjëherë gjithashtu nga familja në familje ndryshon, nëse dhuna vlerësohet si e justifikuar apo si padrejtësi. Kjo varet nga vlerat dhe traditat përkatëse, për shembull nga koncepti, si një burrë ose një grua duhet të sillet ose çfarë vlerë kanë fëmijët kundrejt të rriturve. Dhunën edhe e nxit koncepti, që mund të ekzistonin ndryshime në vlerën e njerëzve në varësi të përkatësisë etnike ose fetare.

Ky vlerësim shoqëror ndryshon me kalimin e kohës, kështu si jetesa dhe gjithashtu vlerat dhe traditat e një shoqërie ndryshojnë me kalimin e kohës. Me këtë gjithashtu lidhet zhvillimi i të drejtave dhe ligjeve përkatëse të një vendi.

Fëmijët kanë një të drejtë për edukim pa dhunë

NDRYSHIM NË QËNDRIMIN NDAJ DHUNËS

Para 50 vjetësh, në Gjermani mësuesit dhe mësueset patën të drejtën të godisnin nxënëset dhe nxënësit me thupër për t'i edukuar. Që nga viti 1973, kjo është ndaluar me ligj. Veç kësaj që nga viti 2000, fëmijët kanë të drejtën për një edukim pa dhunë në familje sipas nenit 1631 paragrafi të *Kodit Civil (BGB)*. Në brezin e prindërve dhe sidomos të gjyshërve të tyre, dënimi fizik brenda familjes ishte ende i zakonshëm.

Njëkohësisht me këtë, vlerat në edukimin e fëmijëve ndryshojnë. Në brezin e gjyshërve, bindja dhe përshtatja ishin shumë të rëndësishme. Dhuna si dënimi për rregulla të pazbatuara shikohej si e justifikuar, me qëllim që fëmijët të mësonin zbatimin e rregullave. Lëndime fizike ose psikike shumë pak viheshin re ose vlerësoheshin si të pranueshme.

Sot vlen, që fëmijët të rriten në mënyrë të mbrojtur dhe të zhvillohen mirë. Plani i parë nuk është përshtatja me paracaktime ekzistuese, por zhvillimi i një personaliteti të vet. Kjo gjithashtu mbështet mendimin e demokracisë. Një fëmijë sot ka një "Të drejtë për nxitjen e zhvillimit të tij dhe për edukimin drejt një personaliteti të vetëpërgjegjshëm dhe të aftë për marrëdhënie shoqërore", që është caktuar me ligj *(Kodi Social – SGB* VIII neni 1 artikulli 1).

Me gjithë ndryshimin e vlerave dhe të ligjeve, herë pas here ndodh, që prindër dënojnë fëmijët e tyre përmes dhunës fizike ose psikike. Kjo ndodh për shembull nëpërmjet shuplakave, rrahjeve të lehta ose fyerjeve. Pse ndodh kjo? Në edukimin e fëmijëve gjithmonë lindin konflikte ose krijohen situata, në të cilat fëmijëve duhet t'u caktohen kufij. Situata të tilla mund të jenë stresuese për prindërit. Nëse prindërit si fëmijë janë rrahur në situata të tilla, atëherë mund të ndodhë, që në situata stresi ata vetë e ushtrojnë pa dashje po atë trajtim kundrejt fëmijëve të tyre.

Ndoshta edhe nuk kanë ndonjë shembull të mirë, se si mund të sillen në situata të tilla pa dhunë. Ndoshta ata gjithashtu duan të mbajnë vlerat e vjetra, sepse mendojnë, që "as mua kjo nuk më ka bërë dëm". Për ata, që duan të mësojnë një edukim plot respekt dhe pa dënime të dhunshme, në fushën e edukimit të fëmijëve ekzistojnë kurse dhe oferta mbështetjeje të ndryshme (shihni kapitullin 4 Rrugëdaljet nga dhuna).

! **Ndryshime shoqërore, që nevojiten për uljen e dhunës, shpesh janë të lidhura me procese mësimi për njerëzit. Nganjëherë ato kërkojnë gjithashtu gatishmërinë për një rishqyrtim dhe ndryshim të vlerave të veta.**

ÇFARË RËNDËSIE KANË VLERAT DHE TRADITAT NË EMIGRIM?

Si njeri, në fëmijërinë tonë nuk mësojmë vetëm gjuhën e njerëzve, që na rrethojnë, por gjithashtu, se kush duhet të sillet në çfarë mënyrë, për shembull burra dhe gra, njerëz të rinj dhe të moshuar, brenda ambienteve private ose në publik. Këtu përfshihet edhe, kujt i lejohet ushtrimi i dhunës kundrejt kujt. Më shumë në këtë fushë mësojmë brenda familjes sonë. Ky mësim ndodh automatikisht, pa asnjë mundim nga ana jonë për këtë dhe pa e vënë re. Termi profesional për këtë është "shoqërizimi".

Kështu si mund të flasim gjuhën tonë amtare pa i mësuar rregullat gramatikore, ashtu gjithashtu mund të sillemi "në mënyrën e duhur" në vendin tonë pa i mësuar rregullat e bashkëjetesës.

Nëse gjendemi në një vend tjetër, atëherë nuk duhet të mësojmë vetëm gjuhën në mënyrë të re, por gjithashtu rregullat e bashkëjetesës. Për shembull si të përshëndes një person tjetër, sa saktë duhet të zbatoj oraret e pajtuara në takime ose çfarë do të thotë, nëse një grua e huaj me drejtohet mua. Nëse nuk i njoh rregullat e bashkëjetesës, atëherë mund të ndodhë, që të keqkuptohem ose konfrontohem me refuzime, pa kuptuar përse.

Mund të ndodhë, që sillem në mënyrë të pasjellshme, megjithatë që dua të sillem në mënyrë shumë të sjellshme . Madje mund të ndodhë, që me sjelljen time i shkel ligjet, pa e ditur dhe pa e dashur atë. Koha e parë në një vend të huaj prandaj shpesh është një kohë shumë e lodhshme. Por gjithashtu ofron shansin të rishqyrtosh sjelljen e vet e mësuar automatikisht dhe të njihesh me mënyra të reja të sjelljes dhe t'i provosh ato.

Shumë gjëra mund të mësohen përmes vështrimit dhe imitimit. Për përkrahje në njohjen me rregullat e bashkëjetesës në Gjermani veç kësaj ekzistojnë oferta të ndryshme, për shembull kurse gjuhe, kurse integrimi, informacione në faqe interneti ose edhe shërbimin social në strehimoren tuaj. Në paqartësi ose pasiguri ekziston mundësia të pyesni atje. Nëse mënyrat e sjelljes nuk kuptohen, shpesh ndihmon gjithashtu një bisedë, për shembull me njerëz, që vijnë nga i njëjti vend, por jetojnë tashme më gjatë në Gjermani, ose me miq dhe kolegë gjermanë.

Njohja e rregullave të bashkëjetesës është një hap i rëndësishëm për t'ia dalë mbanë në një vend. Njëkohësisht ka shumë të ngjarë, që ekzistojnë gjithashtu rregulla ose mënyra sjelljeje, që njëherë duken të pazakonta. Këtu ka rëndësi të mendosh ose pyesësh, se çfarë kuptimi sjellja mund të kishte. Kështu, një mënyrë sjelljeje shpesh bëhet e kuptueshme dhe mund të pranohet.

Me vlerat dhe të drejtat shoqërore është lidhur gjithashtu pyetja, kujt i lejohet ushtrimi i dhunës ndaj kujt. Do të thotë: Edhe nëse mënyra të caktuara sjelljeje mund të vlerësohen si të drejta, mundet që përmes këtyre shkelen ligje në Gjermani dhe madje janë të dënueshme. Prandaj ka rëndësi t'i njohësh ligjet dhe të drejtat gjermane për t'i mos shkelur ato pa dashje. Veç kësaj, është më e lehtë të mbrosh veten ose persona të tjerë, nëse i njeh të drejtat e veta.

Shembull:
Nëse një person në një bisedë nuk i shikon personit tjetër në sy, atëherë kjo mund të kuptohet njëherë si shenjë mosrespektimi, megjithëse ka mundësi, që është synuar si shenjë mirësjelljeje.

Nëse rregulla sociale duken "të gabuara", shkaku i kësaj mund të jetë gjithashtu, që konceptet e vlerave në vendin e ri dallohen nga konceptet e vlerave të veta të mësuara. Këto mund të jenë koncepte për këtë, çfarë të drejtash kanë për shembull burra, gra, fëmijë, prindër ose edhe anëtarë të fejeve ose grupeve etnike të caktuara.

Shpesh nuk e dimë farë, që kemi mësuar koncepte të caktuara rreth vlerave, sepse më se shumti këto i kemi mësuar pa vënë re. Nganjëherë as nuk e dimë, çfarë konceptesh rreth vlerave kemi saktësisht, sepse na duken normale dhe të vetëkuptueshme. Por, nëse jetojmë në një vend tjetër, ka rëndësi, t'i njohim vlerat e veta si dhe ato të vendit të ri. Shpesh pikërisht ndryshimet ndihmojnë të mendojmë për konceptet e vlerave të veta dhe gjithashtu të huaja ose të shkëmbejmë mendime dhe të diskutojmë rreth tyre.

BAZA LIGJORE DHE LIGJE NË GJERMANI

Të drejtat bazë në Gjermani janë caktuar në *Kushtetutën e Gjermanisë* (artikujt 1 – 19). Të drejta të rëndësishme janë për shembull

- e drejta për jetën dhe pacenueshmëri fizike (artikulli 2, paragrafi 2),
- barazimi i burrit dhe i gruas (artikulli 3, paragrafi 2),
- mbrojtja nga ç'favorizim për shkak të gjinisë, prejardhjes, racës, gjuhës, atdheut dhe origjinës, fesë, koncepteve fetare ose politike ose aftësisë së kufizuar (artikulli 3, paragrafi 3) dhe
- e drejta për lirinë e fesë, të ndërgjegjes dhe liria e besimit fetar dhe botëkuptimor (artikulli 4, paragrafi 1).

Kushtetuta e plotë e Gjermanisë mund të këqyret në internet në faqen www.bundestag.de/grundgesetz (në gjermanisht). Një përkthim të Kushtetutës së Gjermanisë në gjuhët arabe, kineze, angleze, franceze, italiane, perse, polake, ruse, serbe, spanjolle dhe turke gjeni për shembull në faqen www.bamf.de/SharedDocs/Anlagen/DE/Publikationen/Broschueren/das-grundgesetz.html. Kushtetuta e Gjermanisë gjithashtu është përmbajtja e kurseve të integrimit.

Në *Kodin Penal (StGB)* është caktuar, se çfarë veprimesh janë të ndaluara dhe me çfarë mase dënimi ato mund të dënohen nga gjykata.

Kodi Penal në këtë përfshin edhe veprime në fushën private, pra brenda familjeve ose partneriteteve, për shembull gjithashtu për seksualitetin.

Kështu thotë **"neni 177 Ndërhyrja seksuale; shtrëngimi seksual; përdhunimi**
(1) Kush kryen kundër vullnetit të dukshëm të një personi tjetër veprime seksuale ndaj këtij personi ose e shtyn këtë person t'i kryejë ato, ose kush e cakton këtë person për kryerjen ose tolerimin e veprimeve seksuale ndaj një të treti ose nga ana e një të treti, dënohet me dënim me heqje lirie nga gjashtë muaj deri në pesë vjet."

Ky rregullim ligjor vlen edhe për çifte të martuara. Kjo do të thotë, që parimisht të dy persona duhet të bien në ujdi për marrëdhënien seksuale, edhe në martesë. Në këtë, burrat dhe gratë kanë të drejta të barabarta. Nuk ekziston asnjë pretendim për seksualitet, i cili jep ndonjë të drejtë për marrëdhënie ose veprime seksuale pavarësisht nga vullneti i personit tjetër. Partneri ose partnerja gjithashtu nuk lejohet të vihet nën presion. Nëpërmjet kësaj synohet, që vetëvendosja për trupin e vet dhe kështu edhe shëndeti fizik dhe psikik të mbrohen.

Që nga viti 2016 në Gjermani, ngacmimi seksual gjithashtu dënohet me ligj.
Atje përfshihen për shembull puthje të detyruara ose prekje në zonat intime si gjiri ose prapanica, nëse ato kryen kundër vullnetit të personit të cenuar dhe "në mënyrë seksualisht të përcaktuar". (shihni nenin 184i Kodi Penal StGB)

Ngacmimi ndodh në vende publike si për shembull në rrugë, por edhe në vendin e punës. Në këtë, personi i cenuar shpesh zihet në befasi. Autori ka dëshirë të tregojë, që ai ka kontroll dhe pushtet mbi personin.

Viktima përjeton situata të tilla shpesh si shumë poshtëruese dhe ofenduese.

Për marrëdhënien seksuale të të rriturve (nga mosha 18 vjeçare) me fëmijë dhe adoleshentë (nën moshën 18 vjeçare) ekzistojnë rregulla të tjera ligjore. Këtu, marrëdhënia seksuale mund të jetë e dënueshme me ligj pavarësisht nga miratimi i fëmijës ose adoleshentit, për shembull

- veprime seksuale ndaj fëmijëve/me fëmijë nën moshën 14 vjeçare dënohen gjithmonë me ligj (neni 176 Kodi Penal StGB)
- veprime seksuale nga ana e personave përgjegjës (për shembull të afërm, mësues) edhe ndaj adoleshentëve deri në moshën 16 vjeçare dënohen gjithmonë me ligj
- veprime seksuale edhe ndaj adoleshentëve/me adoleshentë deri në moshën 18 vjeçare dënohen me ligj, nëse raporti i varësisë shfrytëzohet për veprime seksuale

Në këto raste flitet për **„abuzim seksual".**

Për fëmijët dhe adoleshentët ekzistojnë ligje të posaçme, nga që ata në një mënyrë veçanërisht të lehtë mund të influencohen nga të rriturit ose për shkak të varësisë së tyre mund të vihen nën presion. Veç kësaj konsiderohet, që fëmijët dhe adoleshentët njëherë duhet të mësojnë të njihen me nevojat dhe kufijtë e veta në lidhje me seksualitetin.

Në Kodin Penal është përcaktuar për martesën, që një lidhje e detyruar martese ndalohet ligjërisht në Gjermani. Kështu thotë **"Neni 237 Martesa e detyruar (1) Kush e detyron një njeri kundër ligjit me dhunë ose duke e kërcënuar atë me një të keqe prekëse për lidhjen e martesës, dënohet me dënim me heqje lirie nga gjashtë muaj deri në pesë vjet. Vepra konsiderohet si e kundërligjshme, nëse ushtrimi i dhunës ose kërcënimi me të keqen për qëllimin e synuar duhet të vlerësohet si jo i moralshëm."**

Në paragrafët e tjerë të nenit 237 është caktuar, që: Gjithashtu është e dënueshme të çosh një person në një territor jashtë Gjermanisë për një martesë të detyruar dhe që tashme përpjekja e një vepre të tillë dënohet me ligj.

Kodi Penal i plotë mund të këqyret në internet në faqen www.gesetzeim-internet.de/stgb/index.html (në gjermanisht), dhe në faqen www.gesetze-im-internet.de/englisch_stgb/index.html (në anglisht).

Mite rreth përdhunimeve ndaj grave

Deri me sot ekzistojnë ende shumë paragjykime për temën. Disa burra dhe gjithashtu gra u hedhin grave, që kanë përjetuar një përdhunim dhe flasin për këtë, një pjesë të fajit për përjetimin. Shpesh thuhet, që gruaja ishte sjellë në mënyrë të gabuar ose që ajo duhet ta kishte mbrojtur veten. Ka rëndësi të kuptohet, që gratë shpesh shtangen nga frika, nëse ato përdhunohen. Ta mbrojë veten, kjo madje mund ta fusë gruan në një rrezik më të madh. Sipas ligjit mjafton një "JO" e thjeshtë.

Një grua asnjëherë nuk mban faj, nëse një burrë e ka përdhunuar atë! Sjellja e saj para ose gjatë një përdhunimi për çështjen e fajit nuk ka farë rëndësi, pra për shembull çfarë rrobash ka veshur ose nëse natën ka dalë vetëm. Fajin gjithmonë e mban autori!

Gjithashtu është ide e gabuar, që autori gjithmonë të jetë një i panjohur: Përdhunimet më të shpeshta kryhen nga individët prej mjedisit më të afërt personal të gruas.

Gjithashtu është ide e gabuar, që një grua, e cila ia hedh fajin një burri, që ky ta ketë përdhunuar atë, ka dëshirë të hakmerret ndaj tij ose t'i bëjë dëm atij. Sipas policisë, hedhje të rrema faji janë jashtëzakonisht të rralla. Ato ndodhin në afërsisht 3 % të të gjitha rasteve. Shumë më shpesh, për përdhunime nuk bëhet fare kallëzim penal, pra në rreth 90 % të të gjitha rasteve. Kjo ndodh, sepse gratë shpesh kanë frikë, që atyre të mos besohet ose sepse ato kanë turp të flasin për veprën.

Burimi: Studimi reprezentativ i Ministrisë Federale për Familjen, të Moshuarit, Gratë dhe Rininë. www.bmfsfj.de/blob/84328/0c83aab6e685eeddc01712109bcb02b0/langfassung-studie-frauen-teil-eins-data.pdf

Një Kod tjetër i rëndësishëm, në të cilin të drejtat dhe obligimet e qytetarëve janë caktuar në përgjithësi, është Kodi Civil (BGB). Ai përfshin ndër të tjera rregullime për kontrata shitblerjeje, borxhe, për marrje ose lëshime me qira ose për trashëgimi. Por në pjesën e katërt të Kodit Civil janë caktuar gjithashtu të drejtat dhe obligimet në familje, këtu pra bëhet fjalë për raportet ligjore midis prindërve dhe fëmijëve si dhe midis të afërmve.

Kështu në Kodin Civil për shembull është caktuar, se çfarë kushtesh paraprake duhet të ekzistojnë për një lidhje martese dhe në çfarë rastesh një lidhje martese ekzistuese mund të anulohet.

Që nga korriku 2017 ka hyrë rregulla ligjore në fuqi, që lidhje martese lejohen vetëm atëherë, nëse të dy personat, që dëshirojnë të martohen, kanë mbushur të paktën moshën 18 vjeçare. Për martesa tashme të lidhura, në momentin e lidhjes së të cilave të paktën një person ka qenë nën moshën 18 vjeçare, ekzistojnë këto rregullime:

Nëse të paktën një person në momentin e lidhjes së martesës ka qenë nën moshën 16 vjeçare, martesa automatikisht konsiderohet si e paefektshme. Për çifte, që kanë kohë të gjatë të martesës, ekzistojnë rregulla tranzicioni.

Nëse ekziston një martesë, në momentin e lidhjes të së cilës të paktën një person ka qenë midis moshave 16 dhe 18 vjeçare, atëherë kjo normalisht anulohet me një vendim gjyqësor. Nga një anulim mund të hiqet dora, nëse me anë të këtij do të krijohej një rast posaçërisht i rëndë për bashkëshortët ose nëse bashkëshorti i mitur respektivisht bashkëshortja e mitur ndërkohë e ka mbushur moshën madhore dhe e vërteton martesën.

Në nenin 1314 par. 2 të Kodit Civil është caktuar, që një martesë e detyruar mund të anulohet. Për këtë duhet parashtruar një kërkesë përkatëse brenda një afati prej një viti (neni 1317 par. 1 fjalia 1 Kodi Civil).

Kodi Civil i plotë mund të këqyret në internet në faqen www.gesetze-im-internet.de/bgb/ (në gjermanisht), dhe në faqen www.gesetze-im-internet.de/englisch_bgb/index.html (në anglisht).

Tekstet e ligjeve jo gjithmonë kuptohen lehtësisht. Në pyetje ose paqartësi mund të jetë një ndihmë të pyesësh tek persona kontaktues të cilësuar, për shembull pranë shërbimit social të një strehimoreje të përbashkët ose pranë zyrave të këshillimit (shihni kapitullin 4 Rrugëdaljet nga dhuna).

MONOPOLI I SHTETIT PËR USHTRIMIN E DHUNËS NË GJERMANI

Një karakteristikë e një forme "moderne" të shoqërisë në krahasim me format "tradicionale" të shoqërisë është "monopoli i shtetit për ushtrimin e dhunës".

"Monopoli i shtetit për ushtrimin e dhunës" duhet të sigurojë, që dhuna të ushtrohet më vetëm nga ana e shtetit dhe shprehimisht vetëm për parandalimin e dhunës ose për dënimin e dhunës së ushtruar jashtë monopolit. Si një përmbledhje pikërisht janë këto pika, që karakterizojnë besimin në shoqëri dhe për shoqërinë:

- supozimi i një bashkëjetese pa dhunë,
- monopoli i shtetit për ushtrimin e dhunës si institucioni, që mundësisht në përgjithësi e siguron këtë bashkëjetesë pa dhunë (dhe, ku kjo nuk funksionon, e rivendos rendin në mënyrë simbolike – përmes dënimeve) dhe
- ideja e përbashkët, që kjo formë e shoqërisë funksionon, domethënë që është në rrugë drejt një të ardhme, ku me kalimin e kohës më pak dhunë mundësohet dhe nevojitet.

Pra, në Gjermani lejohet ushtrimi i masave vetëm me një urdhër shtetëror me qëllimin që nëpërmjet këtyre të parandalohet dhuna e mëtejshme. Këto masa, si përdorimi i prangave të dorës, i mjeteve ngacmuese dhe mpirëse, i shkopinjve gome dhe i armeve të zjarrit, janë rregulluar rreptësisht. Ato duhen paralajmeruar dhe lejohen të përdoren vetëm si mbrojtje nga një rrezik i pranishëm për shëndetin dhe jetën. Veç kësaj, këto masa duhet të jenë brenda relacioneve dhe të përshtatshme.

Kjo gjithashtu do të thotë, që dhuna nuk mund të justifikohet para ligjit me arsye fetare ose nga praktikat "fetare" ose "tradicionale".

Në rastin e ushtrimit të dhunës nga prindërit ndaj fëmijës së tyre, *Zyra e të miturve* duhet ta mbrojë fëmijën sipas detyrës shtetërore. Nëse punonjësit profesionalë të Zyrës së të miturve (si autoritet përgjegjës) arrijnë në konkluzion, që një zhvillim i shëndetshëm i fëmijës është i rrezikuar në familje, atëherë këta mund t'i detyrojnë prindërit të pranojnë ndihma për edukimin.

Në raste të rënda, kanë detyrën ta strehojnë fëmijën në një familje kujdestare ose në një institucion. Edhe këtu, prindërit përkrahen njëkohësisht të mësojnë një edukim pa dhunë, me qëllimin që fëmija mund të kthehet sërish në familje.

3. Pse ekziston dhuna?

Dhuna mund të cenojë çdo person, gra, burra dhe fëmijë refugjatë si dhe vendas. Njëkohësisht edhe çdo person është parimisht në gjendje të ushtrojë dhunë ndaj të tjerëve, nëse ekzistojnë kushte dhe rrethana të caktuara. Për të kuptuar, përse ekziston dhuna, ka rëndësi të vështrojmë rrethanat shoqërore.

Veç kësaj, arsyet për veprimin e dhunshëm mund të gjinden gjithashtu tek personi në veçanti, për shembull situata shumë rënduese ose sëmundje të posaçme psikike e nxitin ushtrimin e dhunës.

RRETHANA SHOQËRORE – DHUNË DHE PUSHTET

Dhuna, pavarësisht në çfarë forme, lidhet me ushtrimin e pushtetit. Pushteti shfaqet në raportet midis njerëzve. Nëse për shembull një person posedon më shumë para, më shumë dije ose arsim, më shumë kontakte sociale, epërsi fizike ose një pozitë më të lartë dhe përmes këtyre ka më shumë të drejta në shoqëri, atëherë ai mund të ndikojë në persona të tjerë dhe kështu mund të kufizojë realizimin e tyre të vetvetes.

Në këtë mënyrë, ai mund të realizojë interesat e vet dhe kështu mund ta forcojë më shumë pozitën e pushtetit. Kjo gjë është lidhur gjithmonë me dhunë, sepse kështu realizimi i vetvetes i personave të tjerë kufizohet më shumë.

Dhuna strukturore

Shpërndarja e pushtetit në një shoqëri kryhet sipas rregullave ose edhe strukturave të caktuara. Nëse pushteti është i shpërndarë në mënyrë të pabarabartë, pra nëse grupe të caktuara personash shpërfillen, për shembull, që ata nuk lejohen të punojnë dhe kështu as të fitojnë para ose, që ata nuk lejohen të shkojnë në shkollë dhe kështu as nuk marrin arsim, atëherë flitet për dhunë strukturore. Dhuna strukturore është një padrejtësi në vetvete. Veç kësaj, ajo nxit gjithashtu dhunën në shkallet e organizatave dhe familjeve.

Shembull:
Nëse në një shoqëri burrat lejohen gjithmonë të punojnë, por gratë vetëm në kushte shumë të kufizuara, atëherë arritshmëria e parave dhe kështu edhe e pushtetit është shpërndare në mënyrë të pabarabartë. Nëse vetëm burrat në familje i fitojnë paratë ose edhe nëse burrat e marrin mbështetjen financiare të shtetit, atëherë ata shpesh e posedojnë pushtetin mbi financat. Posedimi i parave shpesh ka një rëndësi shumë të madhe. Nga ky burojnë varësi. Burri mund të vendosë, çfarë mund të blihet me paratë. Ai kështu mund të ushtrojë presion mbi gruan të bëjë gjëra të caktuara ose mund të parandalojë, që ajo mund t'i blejë sendet e rëndësishme për nevojat e veta.

Pra, dhuna strukturore do të thotë, që ekziston një mungesë ekuilibri në shpërndarjen e pushtetit në shkallën e shoqërisë. Një pjesë të anëtarëve të një shoqërie, pra për shembull gra dhe vajza, kanë me pak të drejta ose më pak mundësi ta mbrojnë vetveten, nëse të drejtat e tyre shkelen. Në asnjë shoqëri pushteti është ndarë në mënyrë të barabartë, megjithatë ekzistojnë dallime të mëdha në masën e pabarazisë. Sa më të mëdha të jenë këto dallime, aq më e madhe është edhe dhuna midis njerëzve, që buron prej këtyre.

Pushteti jo parimisht është diçka negative, por gjithashtu mund të ketë nënkuptimin, që të marrësh përsipër përgjegjësi për një person. Një person, që posedon pushtet mbi një person tjetër, duhet të përdorë atë me shumë përgjegjësi. Për shembull, prindër kanë pushtet mbi fëmijët e vet. Fëmijët janë të varur prej tyre. Prindërit duhet ta shfrytëzojnë këtë pushtet, duke i përkrahur fëmijët e vet me anë të edukimit sa më mirë, me qëllim që këta si të rritur mund të realizojnë jetën e tyre me pavarësi dhe pa ndonjë pushtet të jashtëm. Për këtë ka rëndësi, që prindërit t'u përgjigjen nevojave të fëmijëve, që t'i këqyrin ata si personalitete të pavarura dhe të marrin parasysh edhe mendimet e tyre në vendime, të cilat i cenojnë fëmijët. Pushteti nuk duhet të shfrytëzohej nga prindërit për të realizuar me patjetër konceptet e veta ose për të realizuar nevojat e veta në kurrizin e fëmijëve. Trajtimi i përgjegjshëm përfshin gjithashtu përdorimin e parasë për shpenzimet e jetesës, edhe këtu interesat e fëmijëve duhet të merren parasysh në masën e duhur.

Dhuna institucionale

Brenda institucioneve ekzistojnë rregulla të posaçme, që përcaktojnë, se kush posedon çfarë lloj të drejtash. Këtu gjithashtu ekziston një pabarazi pushteti, e cila është caktuar përmes këtyre rregullave, për shembull midis mësuesve ose mësueseve dhe nxënësve ose nxënëseve, midis eprorëve dhe punonjësve ose midis administratës së një strehimoreje të përbashkët dhe banoreve dhe banorëve.

Këto rregulla mund t'i pengojnë njerëzit të bëjnë atë, çfarë ka rëndësi për ta, për shembull të gatuajnë ushqimin e vet. Kështu ata janë kufizuar në realizimin e tyre të vetvetes. Prandaj këtu flitet edhe për dhunë institucionale. Sado, pushteti i bashkëpunëtorëve dhe bashkëpunëtoreve të strehimoreve nuk duhet të shfrytëzohet nga këta në mënyrë të gabuar dhe për interesat e vet.

ÇFARË KONCEPTESH E JUSTIFIKOJNË DHUNËN?

Njerëz të veçantë mund t'i shfrytëzojnë strukturat e pushtetit në shoqëri, në një institucion ose në familje, për shembull midis gjinive ose midis grupeve të ndryshme etnike për këtë, që ta paraqesin veprimin e tyre të dhunshëm si të justifikuar, edhe nëse ky nuk i shërben shoqërisë, por vetëm interesave personale. Ata e arsyetojnë dhunën e tyre me këtë, që për shkak të pozitës së tyre të pushtetit parimisht e kanë të drejtën të ushtrojnë dhunë.

Përmes interpretimit përkatës të shkrimeve fetare ose përmes ideologjive të ndryshme, pozita e pushtetit në këtë shpesh caktohet si e drejtë dhe e pandryshueshme. Ideologjitë e dhunshme përmbajnë konceptin e njerëzve më të vlefshëm, të cilët lejohen ose madje duhet të sundojnë, vendosin dhe ushtrojnë pushtet dhe dhunë, dhe të njerëzve më pak të vlefshëm, të cilët duhet të "mbrohen", "edukohen ndryshe", "kontrollohen", "konvertohen", luftohen ose madje edhe të shfarosen.

Në këtë, dallimi midis cilësisë "më shumë" ose "më pak të vlefshëm" bëhet në varësi të ideologjisë për shembull për shkak të gjinisë, pra midis burrave dhe grave, për shkak të përkatësisë fetare ose për shkak të ngjyrës së lëkurës ose të përkatësisë etnike. Ky përcaktim faktikisht është arbitrar, nga që çdo njeri është unik në vetvete dhe në veten e tij përfshin karakteristika më të ndryshme. Ndarja e njerëzve të një shoqërie në grupe të cilësisë "më shumë" dhe "më pak të vlefshëm" për shkak të një karakteristike të vetme shërben vetëm për justifikimin e ushtrimit të pushtetit dhe të dhunës.

Të krijohen ekuilibra pushteti

Viktimave të kësaj dhune ideologjike shpesh u mbeten pak mundësi për të luftuar kundër kësaj, sepse të pushtetshmit i caktojnë të drejtat dhe ligjet në shoqëri sipas interesave të vet. Pjesërisht edhe viktimat vetë e pranojnë konceptin ideologjik, që dhuna e ushtruar ndaj tyre është e drejtë, nëse janë rritur në një mjedis me një ideologji të tillë, dhe nuk e mbrojnë vetveten. Kështu sistemi i dhunës mbahet dhe stabilizohet.

Për ta ndryshuar këtë sistem dhe për të ndërtuar një sistem të respektit reciprok dhe të humanizmit, prandaj ka më shumë rëndësi, që njerëzit, që qëndrojnë në pozitën e pushtetit, të angazhohen për një ekuilibër pushteti, në shkallën e shoqërisë, por para se gjithash edhe në shkallën midis njerëzve në familje. Një sistem i tillë i respektit dhe i humanizmit nuk çon në humbjen e mundësisë për t'i përfaqësuar interesat e vet, por e ofron shansin e vlefshëm, që interesat e të gjithëve të realizohen sa më mirë përmes bisedave dhe negociatave, dhe që kështu e gjithë familja ose shoqëria të forcohet.

Dhuna, që ushtrohet kundër një pjese të shoqërisë, të një institucioni ose të një familjeje dhe që nuk e ka qëllimin e uljes së dhunës, e dëmton shoqërinë, institucionin ose familjen e tërë gjithmonë afatgjatë dhe në mënyrë shumë masive. Studime tregojnë, që në shkallë shoqërore ekziston një lidhje midis masës së dhunës dhe varfërisë ekonomike. Dhuna në shkallën e familjes për të cenuarit shpesh i jep pasojat e përshkruara në kapitullin 1. Për marrëdhëniet në familje, dhuna do të thotë, që ato karakterizohen nga pushteti dhe shtypja. Respekt, dashuri dhe përkrahje mund të zhvillohen vetëm atëherë, nëse këta janë reciprokë.

DHUNA KULTURORE DHE FETARE

Dhuna mund të shfaqet nëpërmjet rregullave të sjelljes dhe ndalimeve të përcaktuara, të cilat arsyetohen përmes traditave, vlerave kulturore ose përmes një feje. Në shoqëri patriarkale, pra shoqëri, në të cilat burri vlerësohet si më i vlefshëm se gruaja, veçanërisht për gratë ekzistojnë rregulla të rrepta. Për shembull, gratë kufizohen fort në këtë, se si të vishen, ku të qëndrojnë ose çfarë kontaktesh sociale të mbajnë. Veç kësaj, rregullat për shembull nuk lejojnë, që ato të mbrojnë vetveten nga dhuna në martesë.

Ngacmimi seksual ndodh në shumë situata të jetës së përditshme

Të gjithë njerëzit janë të barabartë para ligjit. Gratë dhe fëmijët i kanë po ato të drejta si burrat dhe mund të vendosin vetë. Ligjet dhe feja janë ndarë nga njëri-tjetri.

Nëse këto rregulla dhe ndalime nuk zbatohen, atëherë traditat, vlerat kulturore ose feja kërkojnë një dënim. Ky mund të jetë për shembull përjashtimi nga shoqëria, urdhri për të mos dalë nga shtëpia, gjymtimi i gjymtyrëve deri në vrasje. Dënimi shpesh kryhet nga ana e familjes. Një shembull janë të ashtuquajtura "vrasjet e nderit", të cilat sipas OKB-së ua marrin jetën më shumë se 5.000 grave në vit në mbarë botën.

Ky dënim nuk i shërben parandalimit të dhunës së mëtejshme, por synon të sigurojë përmes barbarizmit, që të zbatohen rregullat. Në shoqëri patriarkale, jo vetëm rregullat janë shumë më të rrepta për gratë, por edhe dënimi në rastin e shkeljes së një rregulle i cenon gratë shumë më fortë.

Përmes këtyre rregullave njëkohësisht krijohet një trysni sociale të kryhet dënimi dhe të ushtrohet dhuna. Nëse një person e refuzon të kryejë dënimin, atëherë mund të ndodhë, që atij vetë i kërcënohen një dënim ose të paktën pasoja shoqërore si përçmimi ose përjashtimi social.

Në Gjermani ekzistojnë mundësi ta mbrosh vetveten, nëse për shkak të një presioni të tillë social kërcënohesh nga një rrezik. Informacione për mundësitë e mbrojtjes dhe të ndihmës në rastin urgjent i merrni pranë zyrave të këshillimit ose tek policia. (> kapitulli 4: Rrugëdaljet nga dhuna)

KULTURA E DHUNËS

Në vende ose rajone, ku njerëz për shumë vite ose dekada duhet të pësojnë luftë ose luftë civile, dhuna mund të bëhet një pjesë "normale" e jetës së përditshme për këta.

Fëmijët pastaj rriten në një "kulturë dhune", ata e adaptojnë dhunën si një mënyrë normale e të vepruarit për të rregulluar konflikte ose për të realizuar interesa. Mënyra të të vepruarit pa dhunë për zgjidhjen e konflikteve, për shembull përmes negociatave ose ndërmjetësimit, njëherë duhet të mësohen përsëri.

SHKAQE PSIKOLOGJIKE PËR SJELLJE TË DHUNSHME

Duke parë njeriun në veçanti, gjithashtu ngarkesa të mëdha psikike ose një sëmundje psikike mund të jenë një arsye për agresivitet ose për sjellje të dhunshme.

Ngarkesa psikike mund të ekzistojnë për shkak të përvojave nga e kaluara, për shembull dhuna e përjetuar vetë ose përjetime me rrezik vdekjeje gjatë luftës, përndjekjes ose në arratisje. Ato mund të shkaktojnë çrregullime gjumi, dhimbje koke ose barku ose një ngacmueshmëri dhe agresivitet të shtuar. Nganjëherë këto gjithashtu shkaktojnë një konsumim të shtuar të alkoolit ose të drogave të tjera.

Nëse pastaj shtohet një ngarkesë aktuale, për shembull përmes kohërave të gjata të pritjes ose pasigurive në procedurën e azilit, përmes një refuzimi në vendimin e azilit, përmes një dëbimi të kërcënuar, përmes refuzimit të bashkimit familjar, përmes frikës për familjen në vendin e origjinës, përmes konflikteve në strehimore ose përmes përjetimit të racizmit dhe refuzimit në publik, atëherë kjo shpesh rezulton në një stres jashtëzakonisht të madh, i cili mund të shkaktojë një humbje kontrolli dhe një veprim të dhunshëm pa dashje. Kjo formë dhune është shumë e rrallë sipas statistikës, megjithatë mund të ndodhë në raste të posaçme.

Në këto situata të vështira shpesh ndihmon, nëse mund të flasësh me një person të afërt për këto. Gjithashtu shërbimi social në një strehimore të përbashkët ose zyrat e këshillimit (shihni adresat e kontaktit) ofrojnë biseda, që mund të kenë një efekt lehtësues.

Sëmundje psikike

Gjithashtu disa sëmundje psikike të posaçme mund të shkaktojnë, që një person tenton të ushtrojë dhunë në marrëdhëniet midis njerëzve.

Si sëmundje psikike emërtohen shfaqje posaçërisht të forta të cilësive ose karakteristikave personale, pra për shembull mënyra e të menduarit, e të ndierit, e perceptimit dhe e sistemimit të mjedisit ose të sjelljes me njerëz të tjerë. Këto karakteristika shkaktojnë probleme për personin e cenuar vetë ose gjithashtu për njerëzit përreth. Këtu bëhet fjalë për një sëmundje. Kjo do të thotë, që personi i cenuar nuk mund t'i drejtojë ose ndryshojë sipas vullnetit të tij mendimet, ndjenjat ose reagimet e veta.

Ka shumë sëmundje të ndryshme psikike. Emërtimet dhe simptomat e sëmundjeve janë përcaktuar në sistemin e ashtuquajtur ICD-10 ("International Statistical Classification of Diseases and Related Health Problems").

Ndër sëmundjet e shumta dhe të ndryshme psikike ka dy forma të të ashtuquajtura "çrregullimeve të personalitetit", që mund të kenë si pasojë një tendencë të shtuar për dhunë. Ky së pari është **"çrregullimi i personalitetit me paqëndrueshmëri emocionale".** Të cenuarit, që vuajnë nga një çrregullim i tillë personaliteti, preken shpejt në situata kërkuese në kontakte me njerëz të tjerë, si për shembull në konflikte, refuzime ose zhgënjime, ose në shprehjen e pretendimeve.

Ata shumë shpejt ndihen të ofenduar ose të mërzitur dhe janë të tensionuar brenda vetvetes. Kështu, ata shpesh reagojnë në situata të tilla me akuza, me inat ose agresion të pakontrollueshëm ndaj të tjerëve, ose edhe me zhvlerësim të vetvetes ose me tërheqje. Ndjenjat e veta në përgjithësi përjetohen si të pakontrollueshme, ndryshueshme dhe paqëndrueshme, çfarë vështirëson ndërtimin e marrëdhënieve dhe kontakteve të qëndrueshme me njerëz të tjerë. Tensioni brenda vetvetes mund të bëhet aq i fortë, që të cenuarit e lëndojnë vetveten për të gjetur kështu lehtësim. Sëmundja gjithashtu mund të shkaktojë, që të cenuarit mendojnë të vrasin veten ose madje ta bëjnë atë.

Forma e dytë e një çrregullimi të rëndësishëm personaliteti në lidhje me dhunë emërtohet **"çrregullimi anti-social i personalitetit".** Treguesi i kësaj sëmundjeje është, që të cenuarit tentojnë

Gjithkush mund të kontribuojë për një bashkëjetesë pa dhunë

për një sjellje agresive dhe për ushtrimin e dhunës, nga që për ata favori i vet ka parësi dhe nuk pyesin për pasojat e veprimit të tyre për njerëz të tjerë ose ata nuk kanë ndjeshmëri për njerëz të tjerë. Ata shfrytëzojnë njerëz të tjerë për favorin e vet. Të cenuarit shpesh kryejnë krime, nga që zbatimi i ligjeve si gjithashtu i rregullave sociale nuk i intereson farë. Në personalitetin e tyre, të cenuarit shpesh inatosen lehtësisht dhe reagojnë në mënyrë impulsive.

Një çrregullim tjetër psikik, që mund të nxisë ushtrimin e dhunës, është "pedofilia". "Pedofilia" sistemohet si një **"çrregullim i preferencës seksuale".** Të cenuarit tërhiqen seksualisht drejt fëmijëve (para pubertetit). Kjo do të thotë, ata ndjejnë një nevojë të madhe për veprime seksuale me fëmijë. Por në Gjermani këto parimisht janë ndaluar me ligj, për mbrojtjen e fëmijëve (shihni Bazat ligjore dhe ligjet). Për të cenuarit kjo do të thotë, që ata nuk mund t'i përmbushin nevojat e tyre seksuale. Në disa raste, të cenuarit nuk mund t'i kontrollojnë këto nevoja ose t'i mbajnë ato të mbyllura, dhe ndodh ushtrimi i dhunës seksuale ndaj fëmijëve.

Sëmundje psikike mund të trajtohen me *psikoterapi* (shihni kapitullin 4 Rrugëdaljet nga dhuna) dhe me masa të tjera. Në rastin e një "pedofilie" deri tani nuk ka mundësi shërimi, megjithatë një psikoterapi ka shumë rëndësi për të parandaluar sulme seksuale ndaj fëmijëve dhe për të gjetur mundësi për të jetuar me këtë çrregullim.

PASOJAT PËR AUTORIN – A SËMUREN NJERËZIT, QË USHTROJNË DHUNË?

Një sëmundje psikike në disa raste nuk mund të jetë vetëm një shkak për dhunën, por gjithashtu mund të jetë një pasojë e dhunës së ushtruar.

Kështu tek ushtarët ose anëtarët e lidhjeve terroriste, të cilët kanë ushtruar dhunë të qëllimshme, mund të shkaktohet një konflikt i brendshëm psikik, kur ata e kuptojnë padrejtësinë e veprave të tyre. Mund të shkaktohen ndjenja shumë rënduese të fajit ose të turpit, të cilat gjithashtu mund të shkaktojnë një sëmundje psikike, për shembull një traumatizim ose depresion.

Nëse dhuna ushtrohet nga anëtarët e familjes, shpesh nga baballarët ose vëllezërit, për të barazuar shkeljen e rregullave kulturore ose fetare, atëherë besimi në drejtësinë e veprës "mbron" nga ndjenjat e fajit dhe nga një sëmundje psikike. Por edhe në këto raste, njohuria për padrejtësinë mund të shkaktojë pasoja të rënda psikike.

4. Rrugëdaljet nga dhuna

ÇFARË MUND TË BËJ KUNDËR DHUNËS?

Të tregosh respekt

Çdo njeri ka të drejtën për një jetë pa dhunë. Për të ulur dhunën ndaj partneres/partnerit dhe në familje, njëherë ka rëndësi të mendosh në mënyrë kritike për sjelljen e vet.

Në lidhje me partneritetin për shembull mund të ndihmojnë këto pyetje: A e kufizoj unë si burrë partneren time? A ka fusha, ku i jap asaj më pak të drejta sesa vetvetes? A ka situata, në të cilat e ofendoj ose godas partneren time ose ushtroj dhunë në ndonjë mënyrë tjetër ndaj saj? A kam marrëdhënie seksuale me partneren time, edhe nëse ajo eventualisht nuk e dëshiron? Nëse po, pse e bëj këtë gjë? Çfarë më duhet ose çfarë mund të bëj për ta trajtuar atë me respekt dhe pa dhunë?

Në lidhje me sjelljen ndaj fëmijëve të vet, pyetje si këto mund të jenë të rëndësishme, për shembull:

A e respektoj unë të drejtën e fëmijëve të mi për një edukim pa dhunë? Si sillem në situata konfliktesh, a e caktoj unë zgjidhjen dhe e realizoj atë me ngulm ose a jam gati të merrem me dëshirat dhe nevojat e fëmijëve të mi? A ka situata, në të cilat për shembull i godas, ofendoj ose dënoj fëmijët e mi? Nëse po, pse e bëj këtë gjë? Çfarë më duhet ose çfarë mund të bëj për t'i trajtuar fëmijët e mi me respekt?

Për t'i ndryshuar mënyrat e veta të sjelljes, oferta ndihme profesionale mund të ndihmojnë (shihni me poshtë).

Të kërkosh respekt

Siç është përshkruar në kapitujt 2 dhe 3, dhuna ka ndërvarësi gjithashtu me vlerat e vënë në jetë në bashkësi ose shoqëri dhe me mënyrat e pranuara të sjelljes si edhe me strukturat e pushtetit. Ato ndikojnë, që ushtrimi i dhunës ndaj grave ose fëmijëve të jetë më i lehtë. Kjo do të thotë, që gjithashtu ulja e dhunës duhet të nisët nga kjo pikë.

Çfarë mund të bëjë unë si një person i vetëm respektivisht si një burrë i vetëm? Një kontribut i madh është nëse jeta me partneren e vet jetohet pa dhunë dhe me të drejtat e barabarta. Kjo gjë krijon një shembull të fortë për fëmijët e vet dhe gjithashtu për mjedisin social. Ankthe të mundshme dhe pretekste, se çfarë ndodh, nëse burri heq dorë nga roli i tij si "kryefamiljar", mund të hiqen në këtë mënyrë, që kjo jetohet dhe tregohet nga ana e burrit si një vendim i vullnetshëm. Veç kësaj është një kontribut i rëndësishëm dhe veprues, të angazhohesh gjithashtu në mjedisin social, pra për shembull në familje, në rrethin e miqve, në vendin e punës ose në strehimoren e përbashkët për një sjellje

pa dhunë dhe plot respekt ndaj grave dhe fëmijëve.

Shembuj:
Nëse njëri flet në një bisedë në mënyrë poshtëruese ose pa respekt për gratë, atëherë në këtë lidhje nuk duhet heshtur. Duhet treguar qartazi, që për veten një mënyrë të të shprehurit plot respekt dhe një sjellje plot respekt ka rëndësi, dhe prandaj nuk mund të biesh dakord me shprehje të tilla.

Nëse vihet re një situatë, ku një burrë trajton një grua pa respekt ose në mënyrë poshtëruese, atëherë ka rëndësi të mos largohesh pa thënë asgjë. Burri duhet të lajmërohet për sjelljen e tij pa respekt në këtë situatë dhe të urdhërohet për një sjellje me më shumë respekt.

KU MUND TË GJEJ NDIHMË?

Ndihmë në rastin emergjent

Në një rast akut dhune, policia mund të thirret falas në numrin 110. Policia është e detyruar të vijë menjëherë për ta mbrojtur personin e cenuar. Në rastin e një vepre penale, policia duhet të bëjë një kallëzim penal.

Në rastet e dhunës brenda familjes, policia mund ta dëbojë personin e dhunshëm nga banesa e përbashkët për deri më 14 ditë. Policia gjithashtu mund ta arrestojë personin e dhunshëm në mënyrë të përkohshme për ta realizuar dëbimin nga banesa.

Policia në Gjermani i nënshtrohet monopolit të shtetit për ushtrimin e dhunës. Policëve dhe policeve u lejohet ushtrimi i dhunës, për shembull të arrestojnë dike me dhunë, vetëm atëherë, nëse kjo nevojitet për mbrojtjen e sigurisë së të tjerëve ose të personit vetë dhe nëse kjo është paracaktuar me ligj. Policëve dhe policeve nuk u lejohet të veprojnë në mënyrë arbitrare. Çdo formë poshtërimi ose torture në marrjen në pyetje ose në burgim është parimisht e ndaluar.

Në disa raste dhune, për shembull nëse autori vjen nga rrethi i ngushtë i viktimës ose nëse ekziston një varësi, viktima njëherë nuk ka dëshirë t'i drejtohet policisë dhe të bëjë një kallëzim penal, ose nuk është e sigurte a ta bëjë apo jo. Vendimi për pyetjen, nëse dhe kur do të bëhet një kallëzim penal, i përket vetëm viktimës. Ose autorit, nëse lajmërohet vetvetiu tek policia për t'u shmangur ndjekjes penale në të ardhmen dhe për t'ia arritur eventualisht një uljeje dënimi.

MUNDËSI KËSHILLIMI

Pavarësisht nga parashtrimi i një *kallëzimi penal* ose nga thirrja e policisë ekzistojnë mundësi të ndryshme këshillimi.

Këshillim do të thotë, që për situatën e vet të flitet me një profesionist, për shembull me një profesionist të pedagogjisë sociale ose të psikologjisë dhe që bashkëristh të kërkohen mundësi përmirësimi. Në bisedën këshilluese nuk bëhet fjalë për gjykimin e personit, që kërkon ndihmë, ose të sjelljes së tij, gjithashtu nuk bëhet fjalë për një marrje në pyetje, por personi, që kërkon ndihmë, pranohet dhe respektohet kështu siç është. Gjithashtu ai vendos, se për çfarë ka dëshirë të flasë në bisedë dhe për çfarë jo. Vendimi, se si merret më tej me situatën pas këshillimit, i përket vetë personit, që kërkon ndihmë.

Këshilltari ose këshilltarja i nënshtrohet detyrimit të ruajtjes së sekretit, që do të thotë, që atij ose asaj nuk i lejohet të tregojë më tej atë, çfarë është folur. Një përjashtim i detyrimit të ruajtjes së sekretit ekziston atëherë, nëse këshilltari ose këshilltarja arrin në konkluzionin, që mirëqenia e një fëmije rrezikohet ose që ekziston një rrezik akut për jetën e personit, që kërkon ndihmë, ose të një personi tjetër. Nëse këtu nuk jeni të sigurt, pyesni në fillim të bisedës këshilluese, në cilat raste konkrete detyrimi i ruajtjes së sekretit nuk është në funksion.

! **Shumica e ofertave të këshillimit janë falas.**
Shumë ofrojnë një shërbim përkthimi.

Për viktimat e dhunës si dhe për personat, që ushtrojnë dhunë, në Gjermani ekzistojnë në varësi të rajonit ose të vendbanimit oferta të ndryshme këshillimi të specializuara, për shembull zyra këshillimi ose edhe mundësi të këshillimit telefonik (shihni adresat e kontaktit). Këto oferta këshillimi mund të shfrytëzohen gjithashtu nga personat, që janë të kërcënuar nga dhuna ose që janë nën presion të ushtrojnë dhunë, për shembull për të rivendosur nderin e familjes. Gjithashtu miqtë ose të afërmit mund të këshillohen, se si mund të ndihmojnë një person, që pësON ose ushtron dhunë.

Disa oferta këshillimi ofrojnë përkrahje posaçërisht për gra ose posaçërisht për burra. Në këtë ka më shumë oferta këshillimi për gra, nga që ato në Gjermani janë cenuar më shpesh dhe më fort nga dhuna.

Në konflikte me partnerin/partneren ose brenda familjes, gjithashtu ekzistojnë oferta këshillimi, në të cilat çifti bashkëristh ose familja në tërësi mund të marrë pjesë (shihni adresat e kontaktit).

Nëse banoni në një strehimore të përbashkët, shërbimi social mund t'ju përkrahë në kërkimin e një përkthyesi të përshtatshëm ose në pajtimin e një takimi këshillues.

PSIKOTERAPI

Në sëmundje psikike ose në lëndime shpirtërore apo në simptoma si stres, mungesë gjumi, agresivitet, dëshpërim ose dhimbje, që nuk kanë ndonjë arsye fizike, një psikoterapi mund të ndihmojë.

Në një psikoterapi, trajtimi bëhet në formë bisedash me psikoterapistë ose psikoterapiste ose me psikiatër dhe psikiatre. Nganjëherë bëhen edhe ushtrime ose jepen ushtrime si detyra shtëpiake. Një psikoterapi mund të zgjatë deri në dy vjet.

Në një bisedë psikoterapie ndër të tjerat i bëhen pyetje personit, që kërkon ndihmë. Por këtu nuk bëhet fjalë për një marrje në pyetje, por të kuptohet situata mirë dhe kështu të nxirret një diagnozë. Vetëm kështu mund të zhvillohen hapa për një trajtim të përshtatshëm. Nëse dikush nuk është i sigurt, nëse faktikisht ekziston një sëmundje psikike, gjithashtu një bisedë e parë mund të shfrytëzohet për sqarim.

Psikoterapistë ose psikoterapiste dhe psikiatër ose psikiatre, si edhe përkthyes dhe përkthyese i nënshtrohen detyrimit të ruajtjes së sekretit.

Në disa strehimore të përbashkëta, biseda psikoterapie ofrohen direkt në vend. Në varësi të rajonit mund të shfrytëzohen gjithashtu oferta psikoterapie të specializuara për refugjatë (shihni adresat e kontaktit), megjithatë këtu mund të ketë kohëra pritjeje prej disa javësh ose muajsh, derisa lirohet një vend terapie. Në kërkimin e një psikoterapie ose në sqarimin e një sipërmarrjeje shpenzimesh, për shembull shërbimi social në një strehimore të përbashkët ose edhe zyrat e këshillimit mund të ndihmojnë.

Një udhëzues për parashtrimin e kërkesës për një psikoterapi për refugjatë mund të shkarkohet nga interneti në faqen: www.baff-zentren.org/wp-content/uploads/2017/03/BAfF_ Arbeitshilfe_Therapiebeantragung.pdf

KURSE PËR NJË EDUKIM PA DHUNË

Në shumë vende ofrohen kurse, se si fëmijët mund të edukohen pa ushtrim dhune. Këtu jepen informacione për zhvillimin dhe për nevojat e fëmijëve, për reagime të përshtatshme në situata kritike dhe për mundësitë e marrjes me konflikte. Njëkohësisht ekziston mundësia, të shkëmbehen mendime me prindër të tjerë.

Këto kurse ofrohen pjesërisht gjithashtu posaçërisht për prindër me përvoja emigrimi (shihni adresat e kontaktit).

Fjalor

Borderline (= çrregullim personaliteti me paqëndrueshmëri emocionale)	Sëmundje psikike, që ndikon në personalitet. Të cenuarit përjetojnë luhatje të shpejta dhe ekstreme të gjendjes shpirtërore dhe shpesh sillen në mënyrë impulsive. Ata kanë vështirësi të ndërtojnë raporte të qëndrueshme me njerëz të tjerë dhe shpesh ndihen bosh brenda vetes.
Çrregullim personaliteti me ankth dhe reagime shmangieje	Sëmundje psikike, që karakterizohet me një ndjeshmëri jashtëzakonisht të madhe nga dëbimi dhe refuzimi nga ana e të tjerëve, si dhe me konfliktin e brendshëm, që dëshira e fortë për afërsi njerëzore nuk mund të përmbushet për shkak të ankthit të madh nga refuzimi.
Çrregullimi i funksionimit	Tërësia e njerëzve, që jetojnë së bashku në rrethana të caktuara politike, ekonomike dhe sociale.
Denoncim/kallëzim penal	Njoftimi i policisë ose i prokurorisë për një vepër penale të mundshme me qëllimin, që vepra të dënohet dhe të kryhet një dëmshpërblim. Një kallëzim penal mund të bëhet nga çdokush, që ka marrë vesh për një vepër penale të mundshme. Denoncimi është falas. Në rastin e parashtrimit të një denoncimi, autoritetet përkatëse detyrohen të kryejnë hetime dhe të sqarojnë gjendjen eventuale të veprës sa më shumë të jetë e mundur.
Depresion	Sëmundje psikike, karakteristikat e së cilës veçanërisht janë trishtim i zgjatur, mungesë interesi, ndjenja faji dhe një ndjenje shumë e ulët e vlerës së vetvetes, çrregullime gjumi, lodhje dhe mungesë oreksi. Të cenuarit kanë vështirësi të punojnë, të mësojnë ose të rregullojnë jetën e përditshme.
Deprivim	Gjendja e mungesës së gjërave ose ngacmimeve të nevojshme për përmbushjen e nevojave të rëndësishme.
Detyrimi i ruajtjes së sekretit	Detyra ligjore e grupeve të ndryshme profesionistësh, të mos ua kalojnë informacione personave të tretë
Disfunksionim	Çrregullimi i funksionimit
Fizik	Çfarë i përket trupit

Klitor	Pjesë e organeve gjinore femërore, organi i rëndësishëm për ndjenjën e kënaqësisë seksuale.
Kodi Civil (BGB)	Ai përmban ligje të së drejtës së përgjithshme private, pra të raporteve ligjore midis personave privatë, në Gjermani. Ndër të tjera përmbajtja është e drejta familjare me përcaktimet ligjore për lidhjen dhe ndarjen e martesës dhe për përgjegjësinë prindërore. Kodi Civil i plotë mund të këqyret në internet në faqen www.gesetze-im-internet.de/bgb/ (në gjermanisht), dhe në faqen www.gesetze-im-internet.de/englisch_bgb/index.html (në anglisht).
Kodi Penal (StGB)	Përfshin veprat, që dënohen me ligjin gjerman në fuqi dhe pasojat e tyre juridike. Kodi Penal i plotë mund të këqyret në internet në faqen www.gesetze-im-internet.de/stgb/index.html (në gjermanisht), dhe në faqen www.gesetze-im-internet.de/englisch_stgb/index.html (në anglisht).
Kodi Social (SGB)	Përfshin të drejtën sociale, e cila është në Gjermani në fuqi, rregullon pagesat e ndihmës dhe të mbështetjes shtetërore, me qëllim që mund të bëhet një jetë me dinjitet njerëzor, nëse kjo nuk është e mundur me forcën e vet, për shembull në fushat e ndihmës për fëmijë dhe adoleshentë, e nxitjes së punës ose e ndihmës sociale.
Kushtetuta e Gjermanisë (GG)	Kushtetuta e Republikës Federale të Gjermanisë, ajo përfshin vendimet thelbësore për sistemin shtetëror dhe për vlerat dhe qëndron mbi të gjitha normativat ligjore të tjera gjermane. Kushtetuta e plotë e Gjermanisë mund të këqyret në internet në faqen www.bundestag.de/grundgesetz (në gjermanisht). Një përkthim të Kushtetutës së Gjermanisë në gjuhët arabe, kineze, angleze, franceze, italiane, perse, polake, ruse, serbe, spanjolle dhe turke gjeni për shembull në faqen www.bamf.de/SharedDocs/Anlagen/DE/Publikationen/Broschueren/das-grundgesetz.html.
Milic	Forca ushtarake, që kanë vetëm një formim të shkurtër profesional ose që krijohen vetëm në rastin e nevojës.
Normativë	Pritja sunduese në një grup ose shoqëri, se si njerëzit duhet të sillen në situata të caktuara.
Psikiatër/psikiatre	Mjek/mjeke i/e specializuar (mjek/mjeke me një formim të mëtejshëm) për diagnozën mjekësore, trajtimin dhe hulumtimin e çrregullimeve psikike, ofron psikoterapi dhe mund të japë receta për ilaçe.

Psikikë	Përfshin jetën emocionale, të menduarit dhe të vepruarit të një personi.
Psikoterapi	Trajtimi i sëmundjeve psikike në bazë të njohurive dhe procedurave psikologe, shpesh në formë bisedash.
Psikoterapist/ psikoterapiste	Mjek/mjeke, psikolog/psikologe ose pedagog/pedagoge me një formim të mëtejshëm të njohurisë speciale, që ofrojnë psikoterapi.
Social	I përket raporteve të njeriut me njerëz të tjerë brenda bashkësisë ose mjedisit të tij.
Traumë	Një lëndim i thellë psikik përmes një përjetimi, i cili përjetohet në mënyrë jashtëzakonisht kërcënuese, të cilin një njeri nuk mund ta përballojë dhe prandaj sëmuret shpirtërisht për kohë të zgjatë.
Zyra e të miturve	Pjesë e administrimit komunal, detyrat thelbësore janë këshillimi dhe përkrahja ligjore e prindërve dhe të personave me të drejtë edukimi, ndihma për edukimin dhe sigurimi i mbrojtjes së fëmijëve dhe adoleshentëve, sipas kornizave ligjore.
Zyra këshillimi	Institucione, që ofrojnë ndihmë dhe përkrahje në probleme dhe vështirësi të ndryshme. Këshillimi mund të kryhet në bisedë personale, por pjesërisht gjithashtu nëpër telefon, e-mail ose chat.

Shënime

Adresa të zgjedhura kontakti

Beratung für Männer gegen Gewalt
Tieckstraße 41
10115 Berlin
Tel.: 030 785 982 5
www.volkssolidaritaet.de/berliner-volkssolidaritaet/beratung-hilfe/beratung-fuer-maenner-gegen-gewalt/

Këshillimi për burra kundër dhunës
Zyra e kontaktit dhe këshillim për autorë, që ushtrojnë dhunë. Lidhja telefonike e kontaktit për biseda individuale me një psikolog/e. Zhvillimi i një veprimi pa dhunë si dhe punë parandaluese në grupe.

Berliner Zentrum für Gewaltprävention (BZfG) e. V.
Hohenzollernring 106
13585 Berlin

Qendra e Berlinit për parandalimin e dhunës (BZfG) e. V. (Shoqata e regjistruar)
Qendra për mësimin e strategjive alternative të sjelljes kundrejt ushtrimit të dhunës. Oferta për grupe kursi, ushtrime, pasqyrime në grupe si dhe përpunimi i situatave të veçanta të konfliktit

Männernetzwerk Dresden e. V.
Schwepnitzer Straße 10
01097 Dresden
Tel.: 0351 810 434 3
www.escape-dresden.de

Rrjeti i burrave Dresden e. V. (Shoqata e regjistruar)
Bartësi i pavarur për punë me adoleshentë dhe burra. Institucione për ndihmën e adoleshentëve, ofertë këshillimi dhe trajnimi në raste të dhunës brenda familjes dhe punë-kundër-dhunës që u drejtohet autorëve.

Fachstelle für Gewaltprävention
Herdentorsteinweg 37
28195 Bremen
Tel.: 0421 794 256 7
www.fgp-bremen.de

Zyra e specializuar për parandalimin e dhunës
Një institucion i mbrojtjes së viktimave, ofertat për ndihmë të të cilit u drejtohen të fajësuarve dhe shkaktarëve të dhunës fizike dhe seksuale. Oferta e bisedave këshilluese gjithashtu përmes internetit.

Hamburger Gewaltschutz-Zentrum
Altonaer Straße 65
20357 Hamburg
Tel.: 040 280 039 50
www.hamburgergewaltschutzzentrum.de

Qendra e Hamburgut për mbrojtjen nga dhuna
Zyra e këshillimit për njerëz, që lajmërohen vetë, dhe për persona të caktuar nga ana e drejtësisë ose nga ana e zyrave të tjera.

Jedermann e.V.
Lutherstraße 15 – 17
68169 Mannheim
Tel.: 0621 410 73 72
www.jeder-mann.de

Çdokush e.V. (Shoqata e regjistruar)
Zyra e specializuar për parandalimin e dhunës dhe për ndërhyrje. Këshillimi dhe terapia për burra të caktuar nga ana e gjykatave dhe për burra jo të caktuar, trajnim kundër dhunës dhe ndërhyrje krize në rastin e dhunës.

Männerbüro Hannover e.V.
Ilse-Ter-Meer-Weg 7
30449 Hannover
Tel.: 0511 123 589 10
www.maennerbüro-hannover.de

Zyra e burrave Hannover e.V. (Shoqata e regjistruar)
Shoqata bamirëse, që merret me situatat e jetës të djemve, të adoleshentëve mashkull dhe të burrave si dhe me mjedisin social të tyre dhe angazhohet për interesat e tyre. Këshillim në punën me viktimat dhe autorët.

Münchner Informationszentrum für Männer (MIM)
Feldmochinger Straße 6
80992 München
Tel.: 089 543 955 6
www.maennerzentrum.de

Qendra e Mynihut e informacionit për burra (MIM)
Zyra e këshillimit dhe iniciativa e vetë-ndihmës për burra. Oferta për grupe burrash të vetë-ndihmës dhe të vetë-përjetimit me qëllimin e zhvillimit të një sigurie pozitive mashkullore në vetvete.

Projekt STOP-Training
Neue Kasseler Straße 3
35037 Marburg
Tel.: 06421 307 807 4
www.juko-marburg.de

Projekt trajnimi STOP
Bartësi i pavarur bamirës i shërbimeve sociale dhe i ofertave për ndihmën e adoleshentëve dhe në konflikte.

Sozialberatung Stuttgart e.V. – Fachstelle Gewaltprävention
Charlottenstraße 42
70182 Stuttgart
Tel.: 0711 945 585 310

Këshillimi social Stuttgart e.V. (Shoqata e regjistruar) – Zyra speciale e parandalimit të dhunës
Zyra e kontaktit për informacione, këshillime dhe masa trajnimi për temat: dhuna brenda familjes, dhuna në rrugë dhe dhuna e adoleshentëve.

Verein Kinder- und Jugendhilfe e.V. TAET HG
Mainzer Landstraße 625
65933 Frankfurt
Tel.: 069 384 729
www.vkjh-frankfurt.de

Shoqata e ndihmës së fëmijëve dhe adoleshentëve e.V. (Shoqata e regjistruar) TAET HG
Institucioni për masa ambulante të ndihmës së adoleshentëve për adoleshentë dhe persona në zhvillim, që kanë kryer vepra penale.

Mbrojtja dhe siguria nga dhuna

Udhëzues për burra refugjatë dhe të sapoardhur

Ky udhëzues përmban informacione rreth temës së mbrojtjes nga dhuna në Gjermani dhe u drejtohet burrave refugjatë dhe të sapoardhur në Gjermani. Me këtë duam t'ju japim një hyrje në temën e gjerë. Ne ju ofrojmë informacione për të drejtat tuaja, për oferta ndihme dhe ligje për mbrojtjen nga dhuna në Gjermani.

- shkaqet, format dhe pasojat e dhunës
- Kush mbron nga dhuna – dhe si?
- ndryshime në qëndrimin ndaj dhunës
- Rrugëdaljet nga dhuna
- adresat e ofertave të ndihmës për të cenuarit dhe të afërmit

Udhëzuesi u zhvillua në kuadër të projektit federal „MiMi-Parandalimi i dhunës me emigrante për emigrante".
Porositë mund të kryhen nëpërmjet faqeve të internetit „www.mimi-gegen-gewalt.de" dhe „www.mimi-bestellportal.de".

Die Beauftragte der Bundesregierung für Migration, Flüchtlinge und Integration

Ethno-Medizinisches Zentrum e.V.

DHBW Duale Hochschule Baden-Württemberg Villingen-Schwenningen

LANDKREIS MARBURG BIEDENKOPF

bipoli Bildungspolitische Initiative e.V.

Kreis Gütersloh weltgewandt & bodenständig

STUTTGART

Sächsische Landesvereinigung für Gesundheitsförderung

Verband Kinder- und Jugendarbeit Hamburg e.V. Fachverband für die Offene Arbeit mit Kindern und Jugendlichen

AWO Interkulturell Vielfalt verbindet!

Ky udhëzues u dorëzua nga: